




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 213/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Goran Milenković– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Toifor" SH.P.K.- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për Lot 3, ku është rekomanduar për kontratë OE "Dardania" Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblokimi i kanalizimit atmosferik " i ndarë në 6 Lote, me numër të prokurimit: 616-18-440-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datën 31.05.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Toifor" SH.P.K.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblokimi i kanalizimit atmosferik " i ndarë në 6 Lote, me numër të prokurimit: 616-18-440-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblokimi i kanalizimit atmosferik " i ndarë në 6 Lote, (Lot 3) me numër të prokurimit: 616-18-440-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë dhe lënda kthehet në Rivlerësim për Lot 3 .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“Toifor”SH.P.K-Prishtinë,aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:27.08.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:13.11.2018

Njoftimi me letër standarde për tenderuesin e suksesshëm, Lot 3dt: 10.12.2018

Njoftim ne kthim për rivlerësim me dt: 18.12.2018

Njoftimi me letër standarde për tenderues te eliminuar dt: 25.01.2019

Kërkesë për qasje ne dokumentet zyrtare dt: 30.01.2019

Kërkesë për rivlerësim dt: 30.01.2019

Vendimi i ri i vlerësimit dt:04.02.2019

Njoftimi me letër standarde për tenderuesin e suksesshëm dt: 26.04.2019

Kërkesa për rishqyrtim nga “Toifor”medt:02.05.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 06.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Toifor”SH.P.K.-Prishtinë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me15.05.2019me nr. 213/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës për Lot 3, ku është rekomanduar për kontratë OE “Dardania” Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve,debllokomi i kanalizimit atmosferik “ i ndarë në 6 Lote, me numër të prokurimit: 616-18-440-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë,duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin6, 7,52, 59 dhe 69të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe
- Dispozitat e vendimit të PSH nr. 61, 62 dhe 65/19 te dt: 27.03.2019

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.05.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 23.05.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Ky aktivitet i prokurimit është vlerësuar tri herë nga ana e AK-së, dhe fillimisht për kontratë për llot III është rekomanduar OE. "Toifor", por ky rekomandim është anuluar edhe pse për këtë llot nuk ka pasur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së, dhe as ankesë në OSHP.

Autoriteti Kontraktues fillimisht për kontratë ka rekomanduar OE si në vijim:

1. Lot 1 OE. "Ve-mor" me çmim prej 179,398.05€
2. Lot 2 OE "Pastrimi" me çmim prej 126,975.14€
3. Lot 3 OE "Toifor" me çmim prej 409,969.38€
4. Lot 4 OE "Niti-N& Milenium Konstruktion" me çmim prej 194,391.65€
5. Lot 5 OE "Zahiri" me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 OE "ElBau" me çmim prej 283,927.96€

Operatori Ekonomik "Dardania" në vlerësimin e parë të ofertave nuk është rekomanduar për asnjë llot, ndërsa pas Kërkesës për Rishqyrtim Autoriteti Kontraktues i kishte rivlerësuar ofertat dhe OE. "Dardania" e kishte rekomanduar për llot I me çmim prej 261,722.50 €, ndërsa fillimisht për këtë llot ka qenë i rekomanduar OE. "Ve-mor" me çmim prej 179,398.05 €

Rekomandimi për kontratë për lloje sipas vlerësimi të datës 25.01.2019 ishin si në vijim:

1. Lot 1 OE. "Dardania" me çmim prej 261,722.50€
2. Lot 2 OE. "Elbau" me çmim prej 245,418.44 €
3. Lot 3 - Anulohet
4. Lot 4 OE. "Niti-N& Milenium Konstruktion" me çmim prej 194,391.28€
5. Lot 5 OE, "Zahiri" me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 - Anulohet

Autoriteti Kontraktues pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE. "Dardania" për LOT 1, 2, 4 dhe 6 llotin nr. 3 e kishte anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Në lotin nr 3 nuk ka pas ankesë dhe as kërkesë për rishqyrtim, dhe AK pas marrjes se vendimit për shpërblim për kontratë nga OE te rekomanduar kishte kërkuar vërtetimi nga gjykata , ATK-ja dhe sigurimin e ekzekutimi të kontratës .

AK lidhur me anulimin e lloteve 3 dhe 6 edhe pse nuk ka pas ankesë apo Kërkese për Rishqyrtim është arsyetuar gjoja është i nevojshëm kombinimi i lloteve , por në fakt një gjë e tillë nuk ka ndodh, dhe me këtë rast AK e ka pas të qartë se vet ndarja e tenderit në lloje nënkupton se çdo llot i ndare është kontrate në vete, që do të thotë se parashtrim i një ankese në llotet tjera nuk nënkupton anulim të lloteve ku nuk është parashtruar ankesë eventuale nga ana e ndonjë ofertuesi-pjesëmarrësi të pakënaqur në tender.

Rezultatet e ri-vlerësimit kane treguar se në katër llotet e rivlerësuar duke përjashtuar llotet III dhe VI oferta totale e për llotet e rekomanduara kishte arritur të jetë mbi 200 mijë Euro me e lartë se sa që ishte nga vlerësimi fillestar i AK-së.

Pas vendimit të Panelit Shqyrtues të datës 27.03.2019 Autoriteti Kontraktues OE. "Toifor" e rekomandon për kontrate për Llot I ndërsa për llot III e rekomandon OE "Dardania", me çmim prej 413,301.27 Euro, edhe pse OE."Toifor kishte çmim 409,969.38 Euro, dhe fillimisht nga vet AK ishte rekomanduar për këtë llot.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore të OE. "Toifor"

OE. "Toifor" fillimisht kualifikohet i përgjegjshëm dhe rekomandohet për kontratë për Llot 3, por pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE "Dardania" për llotet 1,2,4 dhe 6 Autoriteti Kontraktues pa ndonjë arsyetim e anulon llotin 3, që do të thotë se pa u plotësuar asnjë dispozitë e nenit 62 të LPP-së.

Sipas raportit të vlerësimit të datës 25.04.2019 OE "Dardania " rekomandohet për lot III, ndërsa OE ankues për Llot I

Duke u bazuar në pretendimet ankimore Eksperti Shqyrtues lidhur pretendimet ankimore konstaton si në vijim:

- Gjatë këtij aktiviteti të prokurimit vlerësimi nuk ka qenë në përputhje me nenin 7 të LPP-së, pasi që tri here është vlerësuar aktiviteti i prokurimit dhe rezultatet e vlerësimit ndryshojnë duke u

thirrur në parimin ekonomikitetit, por nëse marrim për bazë totalin e ofertave dhe mënyrën e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit atëherë nuk kemi të bëjmë me parimet bazë të LPP-së. Vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-se pasi që pajisjet e ofruara të OE.” Dardania “ nuk plotësojnë kërkesat e parashtruara në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit, dhe ketë e dëshmojnë edhe raportet e vlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ku fillimisht AK për llot 3 rekomandon OE ”Toifor”, ndërsa OE “Dardania” nuk e rekomandon për asnjë llot. Në rivlerësimin e dytë AK e anulon këtë lot me arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm ndërsa për herën e tretë e rekomandon OE.”Dardania”

Pretendimi ankimor lidhur mos respektimin e nenit 69 të LPP-së janë të bazuara pasi makineria e ofruar nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.

Kërkesa për 4 cisterna nuk është plotësuar pasi në dosje janë kërkuar 4 cisterna me kapacitet 7m³ ndërsa OE i rekomanduar ofron dëshmi vetëm për tri cisterna. Lidhur me këto makineri OE i rekomanduar ofron një kontratë me për marrje ,me qira ku për pozicionin e cisternave tri makineri janë në pronësi të qiramarrësit dhe ne bazë të dëshmive dy nuk figurojnë se janë cisterna (autobota) për larje të rrugëve për ne të dhënat e tyre flasin se janë kamion mbi 18 ton ,vetëm cisterna me nr. AA-149-NS në librezën e qarkullimit shkruan se është bote për larjen e rrugëve , ndërsa dy makineritë tjera me nr. Regjistrimi AA-629-RD dhe AA-453-MS kane përshkrimin kamion mbi 18 tonë që do të thotë se nuk janë makineri për larje të rrugëve . Makineritë që janë marre me qira faktikisht janë marrë si të vlefshme përmes video incizimeve , por jo përmes gjendjes së vërtetuar me rastin e vizitës në teren të bërë nga ana e AK-së

Sipas librezave të qarkullimit automjet me nr. regjistrimi 631-KS-226 dhe automjeti me targa 01-443-LA nuk kanë përshkrim se janë automjete (cisterna apo autobota) për larje të rrugëve por janë automjete për transportim të ujit

Makineria e prezantuar me nr. regjistrimi 01-245-LA nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit pasi nuk kemi të bëjmë me cisternë për deblokim ujëmbledhësve dhe ujërave atmosferike por kemi të bëjmë me një makineri që në librezë të qarkullimit ka përshkrimin furgon për pastrim të kanalizimeve, që do të thotë se nuk kemi të bëjmë me asnjë lloj cisterne e cila është kërkuar në dosje të tenderit.

Tek aneksi 7 pajisjet e duhura është kërkuar që OE për llot 3 duhet të posedojnë 2 makina fshirëse speciale për trotuare dhe një makinë për pastrim të sheshit dhe sipas ofertës OE i rekomanduar për kontratë për këtë pozicion ofron dëshmi vetëm për një makinë speciale për

pastrim te sheshit e cila dëshmohej me libreze qarkullimi, dhe për këtë OE ankues ka ngritur pretendim se makina e tillë nuk është për pastrim te shesheve, por eksperti ne këtë qeshje nuk mund të jap vlerësim se është makineria adekuate pasi qe vet kërkesat e dosjes nuk e kanë precizuar se çfarë tipi, lloj, madhësie apo çka duhet të përmbajnë makineritë apo çfarë duhet te jenë ato fshesa.

Lidhur me fshesat speciale për pastrim të trotuareve OE i rekomanduar nuk ofron libreza qarkullimi por ofron kontrata të shitblerjes ndërsa ne dosje te tenderit shume qartë theksohet se DUD-at kërkohen për ato automjete qe nuk kane librezë te qarkullimit, makineritë e tilla domosdoshmërisht duhet te kenë librezë qarkullim për ti konsideruar të pranueshme pasi janë makineri qe dalin ne komunikacion, ndërsa DUD kërkohen për makineritë qe qëndrojnë brenda vendpunishteve dhe nuk kane dalje ne rrugë-komunikacion, dhe në dosje shprehimisht është kërkuar librezë qarkullim ndërsa për makineritë qe nuk kane libreze qarkullimi DUD doganor.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK vlerësimin ofertave për këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka bërë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LPP-së, dhe këtë e argumenton fakti se OE. “Dardania” fillimisht nuk është rekomanduar për asnjë llot, me pas është rekomanduar për llot 1 (një) me arsyetimin se për këtë llot plotëson kërkesat e dosjes, dhe ne fund është rekomanduar për llot III.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit AK nuk ka respektuar nenin 7 që ka të bëjë me favorizim/mos diskriminim, nenin 59 vlerësimi dhe krahasimi i ofertave, dhe nenin 69 të LPP-së që ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore të OE ankues “Toifor” janë të bazuara, andaj kërkon që lënda për Lot 3 te kthehet në ri- vlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 28.05.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 28.05.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 31.05.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësit e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Zymerideklaroj: Ne e kemi pranuar akt përcjellësin e ekspertit shqyrtues, ne pike për pik e kam analizuar meqë kjo lëndë është hera e 3-të, pajtona plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues çdogjë që është e cekur në lëndën e përpiluar është e bazuar dhe e saktë e them këtë se vet kam marr pjesë në procesin e verifikimit të lëndës e cila ka qenë në prokurim të KK-Prishtinës dhe atë që unë e kam ataku gjatë kontrollës edhe eksperti shqyrtues e ka dhënë nëpërkëmbje të ngjashme mund të them që 99.9 % janë të gjetura të bazuar dhe nuk kam qasë të shtoj më shumë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Isufideklaroj: Rivlerësimi është kryer sipas vendimit të OSHP-së me nr. 61,62 dhe 65/19 sipas të cilit lënda është kthyer në rivlerësim për të gjitha llojet, në rivlerësim është respektuar neni 59 i LPP-së që do të thotë rivlerësimi është bërë sipas kriterit me çmimin më të ulët të tenderit. OE "Dardania" asnjë herë nuk ka qenë OE i eliminuar përveç se ka qenë OE i pasuksesshëm në vlerësimin e parë, eksperti shqyrtues i ka kontestuar pajisjet e OE "Dardania" përkatësisht Cisternat për të cilat ka lidhur marrëveshje me OE "AlkoImpex" cisternat me targa AA-593-MS dhe AA-629-RD ku për këto pajisje eksperti thotë se nuk janë cisterna apo autobota sepse atyre ju shkruan në të dhëna se janë kamion. Mirëpo në qoftë se i shikojmë pajisjet e OE "Toifor" që i ka paraqitur në listën tek aneksi 7 si cisterna mirëpo tek librezat i shkruan se edhe ato pajisje i shkruan që janë kamion, poashtu 2 cisternat tjera të OE "Dardania" që i posedon vet me targa 631-KS-226 dhe 01-433-LA eksperti ka kontestuar duke thënë se këto pajisje nuk janë cisterna por janë automjete për transport të ujit, a mund të më tregoni ju se a është përshkrimi më i përafërt Cisterne me automjet për transport të ujit apo Automjet për largimin e Boreve me kamionët me 3.5 ton për bartje të mbeturinave ku në vendimin e OSHP-së është thënë e ato automjete për largimin e boreve duhet të pranohen si kamionët pra që i bie se nuk janë respektuara kërkesat e parashtruara në DT dhe njoftim për kontratë tek aneksi 7, mund të hyni në sistemin elektronik në e-prokurim dhe të shikoni dëshmitë librezat, fotografat por mund të ju bashkëngjisim edhe Video Incizimet që na janë dërguar nga OE se çfarë funksioni kryejnë ato pajisje. Ndërsa sa i përket OE "Vemor" dua të cekë se është lëshuar gabim teknik ku është shpallur OE i pasuksesshëm në 1 dhe 2 sepse është deklaruar se sigurimin e tenderit dhe vlefshmërinë e tij do ta vazhdoj

vetëm për lotin 6. Kërkoj që paneli shqyrtues të mos e pranojë mendimin e ekspertit por të vendosë për vendimin e komisionit për rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti shqyrtues z. Sheqiri deklaroj: Pra është AP që është hera e 3-të që diskutohet ku vlerësimi i par me 25.01.2019 nga 6 lotet e ndara OE "Dardania" i cili është i rekomanduar kontratë për lot 3 nuk është rekomanduar për asnjë lot por nga vet Autoriteti Kontraktues, ka bërë kërkesë për rishqyrtim për lot 1, 2, 4 dhe 6 por nuk ka bërë për lot 3, që do të thotë ligjërisht në asnjë rrethanë OE "Dardania" nuk mund të jetë pretendent për kontratë. Autoriteti Kontraktues pas kërkesës për rishqyrtim në llotet e theksuar njëkohësisht e ka anuluar lot 3, nuk e ka njoftuar për pezullimin e prokurimit pas marrjes të rekomandimit të dhënies e kontratës ka kërkuar vërtetimin e Gjykatës, ATK-së ka zotuar për lot 3 dhe llotet tjera ka zotuar mjetet për këtë llot. OE "Dardania" nuk mund të jetë pretendent në aspektin ligjor dhe as teknik profesional nuk i plotëson shumë pika të DT-së, Përfaqësuesja e Autoriteti Kontraktues që i theksoj që i ka në pronësi Eksperti nuk i ka mohuar apo as pohuar ato dy cisterna për bartje të ujit por jo për larje të ujit, është bërë për cisternat e marra me qira nga Shqipëria 2 nga to nuk kanë përshkrim që kanë mundësi të lajnrugët, një pajisjeje shkruan se është autobote për larje të rrugëve në libere shkruan që nuk kanë destinacion të përshkruar, pastaj nëse KK-Prishtina e pranon automjetin, Fshese për larje të parqeve apo shesheve makina që është ofruar nga OE "Dardania" tani plotësisht e sqaroj që nuk kemi të bëjmë me makine të larjeve të shesheve me faktin se është makineri me peshe 7 ton, e cila nuk i dedikohet makinerisë që kërkohet në DT. Automjeti që me specifik që kërkohet është cisterna me mekanizëm përcjellës që nënkupton me deblokim të ujë mbledhëseve dhe në DT shkruan duhet të jetë Cisterne. Por është furgon. Njëkohësisht 2 fshesat tjera speciale nuk janë të dokumentuara me libere qarkullimi por vetëm me kontratë për blerje në DT është kërkuar tek kërkesat profesionale se makineritë duhet të dëshmohen me libere të qarkullimit ndërsa ato në vend punishte mund të dëshmohen me DUD doganor. Konsideroj se është plotësisht i padrejtë rekomandimi i OE "Dardania" për Lot 3 që fillimisht nuk është rekomanduar për asnjë lot në herën e 2-të është rekomanduar për lot 2 i cili ka ofruar çmim mbi 261.000.00 euro ndërsa paraprakisht për këtë llot ka qenë OE "Vemor" mbi 179.000.00 euro pra shumë qartë shihet se vlerësimi nuk është bërë në bazën e parimeve të LPP-së

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Propozoj që ankesa e jonë të aprovohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Kërkoj nga ju nëqoftë se lëndën e ktheni në rivlerësim atëherë ta keni parasysh edhe llot 1 atëherë do të bie në kundërshtim se OE do të shpërblehet vetëm për një llot.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/ teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ky aktivitet i prokurimit është vlerësuar tri herë nga ana e AK-së, dhe fillimisht për kontratë për llot III është rekomanduar OE “Toifor”, por ky rekomandim është anuluar edhe pse për këtë llot nuk ka pasur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së, dhe as ankesë në OSHP.

Autoriteti Kontraktues fillimisht për kontratë ka rekomanduar OE si në vijim:

1. Lot 1 OE. “Ve-mor” me çmim prej 179,398.05 €
2. Lot 2 OE “Pastrimi” me çmim prej 126,975.14€
3. Lot 3 OE “Toifor” me çmim prej 409,969.38€
4. Lot 4 OE “Niti-N& Milenium Konstruktion” me çmim prej 194,391.65€
5. Lot 5 OE “Zahiri” me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 OE “ElBau” me çmim prej 283,927.96€

Operatori Ekonomik “Dardania” në vlerësimin e parë të ofertave nuk është rekomanduar për asnjë llot, ndërsa pas Kërkesës për Rishqyrtim Autoriteti Kontraktues i kishte rivlerësuar ofertat dhe OE “Dardania” e kishte rekomanduar për llot I me çmim prej 261,722.50 €, ndërsa fillimisht për këtë llot ka qenë i rekomanduar OE “Ve-mor” me çmim prej 179,398.05 €

Rekomandimi për kontratë për lloje sipas vlerësimi të datës 25.01.2019 ishin si në vijim:

Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues konstaton se për aktivitetin e prokurimit në fjalë vlerësimi nuk ka qenë në përputhje me nenin 7 të LPP-së, pasi që tri herë është vlerësuar aktiviteti i prokurimit dhe rezultatet e vlerësimit ndryshojnë duke u thirrur në parimin ekonomikitetit, por nëse marrim për bazë totalin e ofertave dhe mënyrën e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit atëherë nuk kemi të bëjmë me parimet bazë të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së pasi që pajisjet e ofruara të OE “Dardania” nuk plotësojnë kërkesat e parashtruara në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit, dhe këtë e dëshmojnë edhe raportet e vlerësimit të ofertave për këtë

aktivitet të prokurimit ku fillimisht AK për llot 3 rekomandon OE "Toifor", ndërsa OE "Dardania" nuk e rekomandon për asnjë llot. Në rivlerësimin e dyte AK e anulon këtë lot me arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm ndërsa për herën e tretë e rekomandon OE "Dardania".

Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimet ankimor lidhur mos respektimin e nenit 69 të LPP-së janë të bazuara pasi që makineria e ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për lot 3 nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Kërkesa për 4 cisterna nuk është plotësuar pasi në dosje janë kërkuar 4 cisterna me kapacitet 7m3 ndërsa OE i rekomanduar ofron dëshmi vetëm për tri cisterna. Lidhur me këto makineri OE i rekomanduar ofron një kontratë për marrje me qira, ku për pozicionin e cisternave tri makineri janë në pronësi të qiramarrësit dhe në bazë të dëshmive dy nuk figurojnë se janë cisterna (autobota) për larje të rrugëve, por të dhënat e tyre flasin se janë kamion mbi 18 ton, vetëm cisterna me nr. AA-149-NS në librezën e qarkullimit shkruan se është bote për larjen e rrugëve, ndërsa dy makineritë tjera me nr. Regjistrimi AA-629-RD dhe AA-453-MS kanë përshkrimin kamion mbi 18 tonë që do të thotë se nuk janë makineri për larje të rrugëve. Makineritë që janë marre me qira faktikisht janë marrë si të vlefshme përmes video incizimeve, por jo përmes gjendjes së vërtetuar me rastin e vizitës në teren të bërë nga ana e AK-së.

Sipas librezave të qarkullimit automjet me nr. regjistrimi 631-KS-226 dhe automjeti me targa 01-443-LA nuk kanë përshkrim se janë automjete (cisterna apo autobota) për larje të rrugëve por janë automjete për transportim të ujit

Makineria e prezantuar me nr. regjistrimi 01-245-LA nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit pasi nuk kemi të bëjmë me cisternë për deblokim ujëmbledhësve dhe ujërave atmosferike por kemi të bëjmë me një makineri që në librezë të qarkullimit ka përshkrimin furgon për pastrim të kanalizimeve, që do të thotë se nuk kemi të bëjmë me asnjë lloj cisterne e cila është kërkuar në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues konstaton se tek aneksi 7 pajisjet e duhura është kërkuar që OE për llot 3 duhet të posedojnë 2 makina fshirëse speciale për trotuare dhe një makinë për pastrim të sheshit, ndërsa sipas ofertës së OE të rekomanduar për kontratë për këtë pozicion, është ofruar dëshmi vetëm për një makinë speciale për pastrim të sheshit e cila dëshmohet me libeze qarkullimi, dhe për këtë OE ankues ka ngritur pretendim se makina e tillë nuk është për pastrim të shesheve, por duke pasqyruar faktin se vet kërkesat e dosjes nuk e kanë precizuar se çfarë tipi, lloj, madhësie apo çka duhet të përmbajnë makineritë apo çfarë duhet të jenë ato fshesa, paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK

duhet ti trajtoj ne pajtim me nenin 7 te LPP-se ofertuesit pjesëmarrës lidhur me kërkesën e cekur si më lart.

Paneli shqyrtues sqaron se lidhur me fshesat speciale për pastrim të trotuareve OE i rekomanduar nuk ofron libreza qarkullimi por ofron kontratat e shitblerjes, ndërsa ne dosje te tenderit shume qartë theksohet se DUD-at kërkohen për ato automjete qe nuk kane librezë te qarkullimit, makineritë e tilla domosdoshmërisht duhet te kenë librezë qarkullim për ti konsideruar të pranueshme pasi janë makineri qe dalin ne komunikacion, ndërsa DUD kërkohen për makineritë qe qëndrojnë brenda vend punishteve dhe nuk kane dalje ne rrugë-komunikacion, dhe në dosje shprehimisht është kërkuar librezë qarkullim ndërsa për makineritë qe nuk kane libeze qarkullimi DUD doganor.

Paneli shqyrtues sqaron se edhe pse aktivitetit ki prokurimit në fjalë është i ndarë në 6 (gjashtë) Lote OE “Toifor”SH.P.K. – Prishtinëka parashtruar ankese vetëm për Lot 3, andaj edhe pretendimet janë shqyrtuar dhe konstatuar vetëm përketë Lot.Paneli shqyrtues sqaron se neni 27/A, i LPP-së, e përcakton ndarjen e një aktiviteti te prokurimit në Lote, e gjithashtu edhe autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka specifikuar : Ndarja nëLote: Po Jo

Objekti i kontratës është i ndare në 6 Lote

Tenderuesi mund të paraqesë tender:

vetëm një pjesë Të gjitha pjesët

Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionet teknike , shih Aneksin 1.

Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është 1 (një).

Ne rast se Tenderuesi ofron çmimin me te ulet ne me shume se një (1) Pjesë (Lot) atëherë ai do te shpërblehet me kontrate për Pjesën (Lotin) që ofron çmimin më të ulët të mundshëm për autoritetin kontraktues.

Andaj Paneli shqyrtues duke u bazuar në te cekurat si me lart konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit është i obliguar që ti përmbahet kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit si dhe ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta bej ne pajtim me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit në fjalë për Lot 3 nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Prishtinë,—Prishtinë,
- 1x1 OE—"Toifor"SH.P.K.- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.